



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .08.2020

**Për mbledhjen Nr. 32, datë 21.08.2020, ora 09:00
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 21.08.2020, ora 09:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 32 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores per procedurat e shitjes se tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”
- 2-** Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW
- 3-** Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
- 4-** Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ylliad” sh.p.k, nr. 9, seria T15, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 97, datë 28.07.2015
- 5-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”
- 6-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e kuotave që përbëjnë 100 % të kapitalit të shoqërisë te shoqëria “Free Co” shpk
- 7-** Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI